



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

Press Unit
Unité de la Presse

© Këshilli i Evropës, 2021. Përkthimi jozyrtar i bërë nën Projektin "Forcimi i institucioneve të Kosovës* në luftën kundër torturës, keqtrajtimit dhe trajtimit degradues". Projekti bashkëfinancohet nga ana e qeverisë Norvegjeze dhe Këshillit të Evropës. Ky përkthim nuk e obligon Gjykatën.

© Council of Europe, 2021. Unofficial translation made under the Project on "Strengthening Kosovo* Institutions in Fight against Torture, Ill-treatment and Degrading Treatment". The project is funded by Norwegian government and the Council of Europe. This translation does not bind the Court.

© Conseil de l'Europe, 2021. Cette traduction non officielle a été faite dans le cadre de Project "Renforcer les institutions du Kosovo* dans la lutte contre la torture, les mauvais traitements et les autres traitements dégradants". Le projet est financé par le gouvernement norvégien et le Conseil de l'Europe. Cette traduction ne lie pas la Cour.

* Të gjitha referencat për Kosovën, si për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe pa ndonjë paragjykim për statusin e Kosovës

* All references to Kosovo, whether the territory, institutions or population, in this text shall be understood in full compliance with United Nations Security Council Resolution 1244 and without prejudice to the status of Kosovo.

* Toute référence au Kosovo mentionnée dans ce texte, qu'elle concerne le territoire, les institutions ou la population, doit se comprendre en plein conformité avec la Résolution 1244 du Conseil de Sécurité de l'Organisation des Nations Unies et sans préjuger du statut du Kosovo.

Fletë faktesh - Arrestimi policor dhe ndihma e avokatit

Shtator 2019

Kjo fletë faktesh nuk obligon gjykatën dhe nuk është e plotë

Arrestimi policor dhe ndihma e avokatit

Neni 6 § 3 (c) (e drejta për ndihmë juridike) të **Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut Drejtave**: "Kushdo që akuzohet për një vepër penale gëzon të drejtën të mbrohet personalisht ose përmes ndihmës juridike sipas zgjedhjes së tij ose, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme të paguajë për ndihmë juridike, t'i sigurohet pa pagesë kur interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë."

"Padyshim se qëllimi kryesor i Nenit 6 [të Konventës] për sa i përket çështjeve penale është të sigurojë një gjykim të drejtë nga një gjykatë kompetente për të zgjidhur ndonjë akuzë penale, por nuk do të thotë që neni nuk ka asnjë zbatim në procedurat paraprake gjyqësore." (**Imbriosca k. Zvicrës**, aktgjykimi i datës 24 nëntor 1993, § 36).

«Që e drejta për gjykim të drejtë të mbetet mjaftueshëm "praktike dhe efektive" ..., neni 6 § 1 [i Konventës] parasheh, si rregull, që qasja në avokat të sigurohet që nga marrja e parë në pyetje e një të dyshuari nga policia, përveç nëse demonstron në dritën e rrethanave të veçanta të secilit rast që ka arsye bindëse për ta kufizuar këtë të drejtë. Edhe kur arsyet bindëse mund të justifikojnë në raste të veçanta mohimin e qasjes në avokat, një kufizim i tillë - pavarësisht nga justifikimi - nuk duhet të paragjykojë padrejtësisht të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 6... Të drejtat e mbrojtjes në parim paragjykojnë në mënyrë të pakthyeshme kur deklaratat inkriminuese të bëra gjatë marrjes në pyetje në polici pa prani të avokatit përdoren për dënim." (**Salduz k. Turqisë**, aktgjykimi i datës 27 nëntor 2008, § 55).

Qasja në avokat

Salduz k. Turqisë

27 nëntor 2008 (Dhoma e Madhe)

I akuzuar e më pas i dënuar për pjesëmarrje në një demonstratë të paautorizuar në mbështetje të PKK-së (Partia Punëtore e Kurdistanit, një organizatë e paligjshme), parashtruesi, në mungesë të një avokati, bëri një deklaratë duke pranuar fajësinë sa ishte në mbajtje policore.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi se kishte pasur **shkelje të Nenit 6 § 3 (c) (e drejta për ndihmë juridike) në lidhje me Nenin 6 § 1** (e drejta për gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ajo gjeti se ndonëse parashtruesi kishte qenë në gjendje të kundërshtonte akuzat në gjyqin e tij, fakti që ai nuk mund të

ndihmohej nga një avokat sa ishte në paraburgim policor kishte ndikuar në mënyrë të pakthyeshme në të drejtat e tij të mbrojtjes, veçanërisht pasi ishte i mitur.

Pishchalnikov k. Ruisë

24 shtator 2009

I arrestuar nën dyshimin e një grabitjeje të rëndë, parashtruesi u mor në pyetje - ditën e arrestimit të tij dhe menjëherë të nesërmen - në mungesë të një avokati, megjithëse ai e kishte treguar qartë një avokat mbrojtës që donte ta përfaqësonte atë. Gjatë këtyre marrjeve në pyetje ai pranoi se kishte marrë pjesë në aktivitetet e një grupi kriminal që përfshinte mes tjerash një vrasje dhe kidnapim, krime për të cilat ai u dënua më vonë.



Gjykata konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me Nenin 6 § 1** të Konventës. Ajo gjeti se mungesa e ndihmës juridike për parashtruesin në fazat fillestare të marrjes në pyetje të policisë kishte dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme të drejtat e tij të mbrojtjes dhe e kishte minuar mundësinë që ai të merrte një gjykim të drejtë.

Dayanan k. Turqisë

13 tetor 2009

Parashtruesi, i cili u akuzua, dhe më pas u dënua pse kishte qenë anëtar i Hezbollahut, nuk kishte ndihmën e një avokati sa ishte në paraburgim policor.

Gjykata konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me Nenin 6 § 1** të Konventës. Ajo gjeti se ai kufizim (i cili ishte sistematik, siç ishte përshkruar nga dispozitat përkatëse të ligjit turk) i të drejtës së një individi të privuar nga liria për të pasur qasje në avokat ishte i mjaftueshëm që ajo të mund të konkludonte se përbënte shkelje të nenit 6 të Konventës, edhe pse parashtruesi kishte heshtur sa ishte në paraburgim policor.

Yesilkaya k. Turqisë

8 dhjetor 2009

Parashtruesit iu refuzua qasja në avokat sa ishte në paraburgim policor, megjithëse ai kishte mohuar çdo përfshirje në veprat penale që ia ngarkonin zyrtarët intervistues.

Gjykata konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me Nenin 6 § 1** të Konventës për shkak të mungesës së ndihmës juridike të parashtruesit gjatë mbajtjes në polici.

Boz k. Turqisë

9 shkurt 2010

I arrestuar nën dyshimin se ishte pjesë e PKK-së (Partisë Punëtore të Kurdistanit, një organizatë e paligjshme), parashtruesi ishte në fund të gjyqit të tij ku u dënua me vdekje për "anëtarësimin në një bandë të armatosur", dënim i cili më pas u shndërrua në burg i përjetshëm. Ai ankohej në veçanti për faktin se nuk kishte qasje në avokat sa ishte në paraburgim policor.

Gjykata përsëriti që kufizimi sistematik i qasjes në avokat në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse **ka shkelur nenin 6** të Konventës.

Brusco k. Francës

14 tetor 2010

Parashtruesi, i cili dyshohej se kishte organizuar një agresion, u mor në paraburgim nga policia dhe u mor në pyetje si dëshmitar, pasi ishte obliguar ta thoshte të vërtetën.

Gjykata konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3** (e drejta për mbrojtje në heshtje dhe për të mos e inkriminuar veten) të Konventës. Sipas Gjykatës, parashtruesi nuk ishte dëshmitar i thjeshtë, por person "i akuzuar për vepër penale", dhe si i tillë duhej të kishte të drejtën të mbrohet në heshtje dhe të mos inkriminonte veten, siç garantohej me nenin 6 §§ 1 dhe 3 të Konventës. Gjendja ishte përkeqësuar nga fakti që parashtruesi nuk u ndihmua nga një avokat deri në orën e tij të 20-të në paraburgim policor. Po të ishte i pranishëm një avokat, ai do të ishte në gjendje ta informonte parashtruesin për të drejtën e tij për të heshtur.

Nechiporuk dhe Yonkalo k. Ukrainës

21 prill 2011

Parashtruesi i parë ankohej në veçanti për padrejtësinë e procedurave kundër tij, e sidomos se dënimi i tij për një numër veprash, përfshirë vrasjen me paramendim për përfitim të kryer pas një komploti me një grup personash, ishte bazuar në deklaratat të bëra pa ndihmën e një avokati.

Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)** të Konventës. Ishte e padiskutueshme nga palët që parashtruesi nuk ishte përfaqësuar ligjërisht deri pas tri ditësh në paraburgim. Parashtruesi e kishte pranuar disa herë vrasjen në fazën e hershme të marrjes në pyetje kur nuk ndihmohej nga avokati, dhe pa dyshim që ishte dëmtuar nga kufizimet e qasjes në avokat pasi që deklaratat e tij në polici ishin përdorur për dënimin e tij.

Mader k. Kroacisë

21 qershor 2011

Në vuajtje të dënimit me burg për vrasje, parashtruesi ankohej në veçanti se ishte rrahur nga policia gjatë marrjes në pyetje në Departamentin e Policisë së Zagrebit, se ishte detyruar të ulej në një karrige dhe se ishte privuar nga gjumi dhe ushqimi gjatë tre ditëve sa u mor në pyetje. Ai po ashtu ankohej se procedurat penale kundër tij kishin qenë të padrejta, veçanërisht pasi i kishte munguar ndihma ligjore gjatë marrjes në pyetje nga policia.

Gjykata konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 në lidhje me Nenin Neni 6 § 1** të Konventës për shkak të mungesës së ndihmës juridike të parashtruesit gjatë marrjes në pyetje në polici. Ndonëse nuk i takonte Gjykatës të spekulonte mbi ndikimin që do të kishte qasja në avokat gjatë ndalimit në polici në procedurat pasuese, ishte e qartë se as ndihma e siguruar më vonë nga një avokat dhe as natyra e procedurave ballafaqese me palën kundërshtare nuk mund të neutralizonin defektet që kishin ndodhur gjatë marrjes fillestare në pyetje. Parashtruesi më tej nuk kishte marrë parasysh të drejtën e tij për ndihmë juridike gjatë marrjes në pyetje në polici, pasi ai ishte ankuar për mungesën e asaj ndihme nga fazat fillestare të procedurave. Gjykata po ashtu vendosi që kishte pasur **shkelje të Nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës si në lidhje me trajtimin e parashtruesit në Departamentin e Policisë në Zagreb ashtu edhe për shkak të dështimit për ta shqyrtuar ankesën e tij.

Huseyn dhe të tjerët k. Azerbaixhanit

26 korrik 2011

Ky rast kishte të bënte me ankesën nga aktivistët e opozitës për padrejtësinë e procedurave penale të ngritura kundër tyre për gjoja nxitje të demonstruesve në dhunë.

Sa i përket ndihmës juridike të parashtruesve gjatë arrestimit të tyre, Gjykata vuri në dukje se tre prej tyre ishin marrë në pyetje pa avokat dhe pa hequr dorë shprehimisht nga e drejta e tyre për ndihmë juridike. Një kufizim i tillë kishte shkelur qartë të drejtat e tyre të mbrojtjes në fazën fillestare të procedurave, në **shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (c)** të Konventës.

Bandaletov k. Ukrainës

31 tetor 2013

Parashtruesi ishte thirrur në një stacion policie me disa të tjerë për t'u marrë në pyetje si dëshmitar në lidhje me një hetim mbi një vrasje të dyfishtë të kryer në shtëpinë e tij. Ai pranoi veprën. Të nesërmen ai u arrestua si i dyshuar dhe u caktua një avokat për ta ndihmuar. Parashtruesi në çdo kohë pas kësaj konfirmonte pranimin e fajësisë. Ai u dënua me burgim të përjetshëm. Parashtruesi ankohej se në fazën fillestare të hetimit ai nuk ishte ndihmuar nga një avokat dhe se gjykatat e vendit nuk kishin arritur të zbusnin dënimin e tij edhe pse ai ishte dorëzuar vullnetarisht në polici dhe kishte pranuar krimin.

Gjykata vendosi se nuk kishte pasur **shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3** të Konventës, duke gjetur se procedurat penale kundër parashtruesit në përgjithësi kishin qenë të drejta. Autoritetet vendore kishin ndryshuar statusin e parashtruesit nga dëshmitar në të dyshuar dhe i siguruan atij një avokat sapo kuptuan që kishin arsye të kapshme për ta trajtuar si të dyshimtë. Në intervistën e tij të parë si i dyshuar, parashtruesi u përfaqësua ligjërisht dhe nuk u morën masa hetimore pas pranimit fillestar të fajësisë para se të caktohej një avokat. Parashtruesi kishte konfirmuar pranimin e fajësisë gjatë gjithë hetimit paraprak dhe procedurave gjyqësore, përderisa përfaqësohej nga disa avokatë të ndryshëm. Pranimi fillestar i fajësisë vështirë se mund të konsiderohej se ishte përdorur për ta dënua atë, pasi gjykata ishte mbështetur ekskluzivisht në masat hetimore të kryera më pas, kur parashtruesi veçse kishte ndihmë juridike. Në fund, edhe kërkesa e parashtruesit për zbutjen e dënimit për shkak të dorëzimit të tij vullnetar ishte shqyrtuar nga gjykatat vendase.

Pakshavev k. Rusionë

13 mars 2014

I burgosur për vrasje dhe i dënuar me dhjetë vjet burgim në janar 2001 - dënim që u konfirmua në tetor 2006 - parashtruesi ankohej se i ishte refuzuar qasja në avokat gjatë marrjes në pyetje dhe gjatë disa ditëve të para të paraburgimit policor në maj 1997. Ai konsideronte se gjatë marrjes në pyetje ishte kërcënuar nga hetuesi se nëse nuk do ta pranonte fajin do të përdhunohej nga shokët e tij të qelisë. Parashtruesi më pas pranoi ta ketë kryer vrasjen por tërhoqi deklaratën e tij gjatë gjykimit kur përfaqësohej nga një avokat. Para Gjykatës, ai ankohej se nuk kishte pasur ndihmë juridike gjatë fazës fillestare të procedurës penale dhe se pranimi i fajësisë në atë fazë ishte përdorur më vonë për ta dënuar atë.

Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3** të Konventës, duke konstatuar se përdorimi i deklaratës së pranimit të fajësisë të bërë pa përfituar nga këshillat ligjore për dënimin e parashtruesit minonte drejtësinë e procedurave në tërësi.

Blai k. Rumanisë

8 prill 2014

Parashtruesi, i cili dyshohej se kishte pranuar ryshfet, ishte vënë nën mbikëqyrjen e policisë. Një palë e tretë që kishte bashkëpunuar me policinë erdhi ta takonte dhe i la një zarf që brenda kishte para në tavolinën e tij. Oficerët e policisë ndërhyrën menjëherë dhe kapën parashtruesin në flagrancë. Në përputhje me ligjin e brendshëm, ata përpiluan një raport të veprës penale. Më vonë atë ditë, parashtruesi u informua për akuzat kundër tij dhe për faktin se ai kishte të drejtë të heshte dhe të takohej me një avokat. Më pas ai kishte ndihmën e një avokati gjatë marrjes në pyetje.

Parashtruesi ankohej në veçanti se ai nuk ishte informuar për të drejtën e tij të mbrohej në heshtje dhe të kishte avokat në kohën kur ai u "kap në flagrancë".

Gjykata vendosi se nuk kishte pasur **shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3** të Konventës në lidhje me mungesën e ndihmës nga një avokat gjatë marrjes në pyetje të parashtruesit nga policia sipas procedurës *flagrante delicto*. Duke vërejtur se sipas ligjit rumun kur një person "kapet në flagrancë" për kryerjen e një vepre penale, autoritetet hetuese duhet të kufizohen brenda pyetjeve në lidhje me provat materiale të gjetura në vendin e ngjarjes *flagrante delicto* dhe nuk duhet ta pyesin personin në lidhje me përfshirjen e tij në një vepër penale, gjykata gjeti se autoritetet hetuese nuk kishin tejkaluar kufirin në rastin e parashtruesit. Ajo po ashtu vuri në dukje se kur parashtruesi ishte marrë në pyetje nga prokurori anti-korrupsion në lidhje me veprën, ai kishte pasur qasje në avokat. Në të gjitha deklaratat e tij, parashtruesi ishte deklaruar i pafajshëm dhe asnjëherë nuk i kishte kundërshtuar deklaratat në procesverbal. Andaj Gjykata gjeti që përdorimi i atyre deklaratave në gjykim nuk mund të thuhet se kishte paragjykuar drejtësinë e gjykimit të tij. Gjykata po ashtu vuri në dukje në përfundim se parashtruesi nuk kishte pretenduar kurrë që deklaratat e tij të para të regjistruara në procesverbal ishin rezultat i detyrimit ose keqtrajtimit.

Carkçı (nr. 2) k. Turqisë

14 tetor 2014

Në vuajtje të dënimit me burgim të përjetshëm për pjesëmarrje në një grabitje të armatosur të një dyqani argjendarie gjatë të cilit pronari i dyqanit u qëllua për vdekje, parashtruesi ankohej në veçanti se procedura penale kundër tij kishte qenë e padrejtë. Ai sidomos pretendonte që deklaratat e marra prej tij pa ndihmën e një përfaqësuesi ligjor, të cilat madje nuk përmbanin as nënshkrimin e tij, ishin përdorur si prova për ta dënuar atë.

Gjykata konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me Nenin Neni 6 § 1** të Konventës për shkak të mungesës së ndihmës juridike të parashtruesit gjatë mbajtjes në xhandarmëri.

A.T. k. Luksemburgut (nr. 30460/13)

9 prill 2015

Ky rast kishte të bënte me dështimin për t'i siguruar parashtruesit ndihmë efektive juridike gjatë intervistës në polici dhe paraqitjes së tij të parë para gjykatësit hetues të nesërmen pasi ishte arrestuar në bazë të një urdhërarresti evropian.

Gjykata gjeti në veçanti se në lidhje me intervistën policore, dispozitat ligjore në fuqi në atë kohë nënkuptonin përjashtimin e ndihmës së avokatit për personat e arrestuar sipas një urdhër arresti evropian të lëshuar nga Luksemburgu. Pasi që gjykata vendore nuk kishte korrigjuar pasojat e mungesës së kësaj ndihme, duke hequr nga arsytimi i saj deklaratat e marra gjatë asaj interviste, Gjykata vendosi që kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me nenin 6 § 1** të Konventës për shkak të mosdhënies së ndihmës juridike gjatë intervistës policore. Më tej sa i përket paraqitjes së parë të parashtruesit para gjykatësit hetues, Gjykata gjeti se mungesa e qasjes në dosje para kësaj seance **nuk** përbënte **shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me nenin 6 § 1**, pasi neni 6 i Konventës nuk garantonte qasje të pakufizuar në dosje para një paraqitjeje të tillë. Megjithatë, Gjykata vendosi që mundësia që parashtruesi të konsultohet me avokatin e tij para kësaj seance nuk ishte e garantuar sa duhet nga ligji i Luksemburgut. Për atë kohë sa parashtruesi nuk kishte qenë në gjendje të bisedonte me avokatin e tij para seancës në fjalë, Gjykata kështu gjeti **shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me Nenin 6 § 1** të Konventës.

Turbylev k. Ruisë

6 tetor 2015

Ky rast kishte të bënte me ankesën e parashtruesit për keqtrajtim në paraburgim policor dhe për padrejtësinë e gjykimit penal kundër tij, në të cilën deklarata e tij e "dorëzimit dhe pranimit", si pasojë e keqtrajtimit të tij dhe mungesës së një avokati, ishte përdorur si provë.

Gjykata vendosi që kishte pasur **shkelje të nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës, si në lidhje me keqtrajtimin e parashtruesit si dhe për shkak të shqyrtimit joefikas të ankesave të tij. Ajo po ashtu konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)** të Konventës, duke gjetur se pranimi si provë i deklaratës së dhënë si pasojë e "dorëzimit dhe pranimit" e kishte bërë gjyqin e parashtruesit të padrejtë. Gjykata vërejti në veçanti se mungesa e një kërkese, sipas ligjit rus, për qasje në avokat për një deklaratë të tillë ishte përdorur për të anashkaluar të drejtën e parashtruesit si i dyshimtë *de facto* për ndihmë juridike. Kjo situatë ishte pasojë e zbatimit sistematik të dispozitave ligjore, sipas interpretimit nga gjykatat vendore. Për më tepër, duke dështuar për të kryer një vlerësim të pavarur e të kujdesshëm të "cilësisë" së deklaratës si provë, dhe në vend të kësaj duke u mbështetur në gjetjet e autoritetit hetues, gjykatat vendore kishin legalizuar përdorimin e deklaratës së "dorëzimit dhe pranimit" të oficerëve të policisë për të dokumentuar pranimin e fajësisë nga parashtruesi të marrë si rezultat i trajtimit të tij çnjerëzor dhe poshtërues pas kapjes së tij nën dyshimin për kryerjen e një krimi.

Dvorski k. Kroacisë

20 tetor 2015 (Dhoma e Madhe)

Ky rast kishte të bënte me refuzimin nga policia për të lejuar një avokat të angazhuar nga prindërit e parashtruesit për ta përfaqësuar atë kur merrej në pyetje në një stacion policie nën dyshimin për vrasje të shumëfishtë, grabitje të armatosur dhe zjarrvënie. Parashtruesi i pranoi veprat pasi nënshkroi një autorizim që e autorizonte një avokat tjetër që ta përfaqësonte atë.

Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3** të Konventës. Ajo gjeti në veçanti se policia nuk e kishte informuar parashtruesin as për disponueshmërinë e avokatit të angazhuar nga familja e tij ose për praninë e avokatit në stacionin e policisë. Gjatë marrjes në pyetje, parashtruesi kishte pranuar veprat për të cilat ishte akuzuar dhe kjo ishte pranuar si provë në gjykimin e tij. Gjykata vërejti se gjykatat vendore nuk e kishin adresuar si duhet atë çështje dhe në veçanti kishin dështuar të marrin masat e nevojshme për të siguruar një gjykim të drejtë.

Bora k. Maltës

12 janar 2016

Ky rast kryesisht kishte të bënte me ankesën nga një shkelës i dënuar se nuk kishte pasur ndonjë ndihmë juridike gjatë marrjes në pyetje në paraburgim policor, që rezultoi nga mungesa e ndonjë dispozite sipas ligjit maltez në fuqi në atë kohë që lejonte ndihmë ligjore gjatë hetimit paraprak dhe marrjes në pyetje nga policia. Për më tepër, parashtruesi ankohej se Gjykata Kushtetuese e Maltës kishte ndryshuar interpretimin e saj të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane në lidhje me të drejtën për ndihmë juridike në paraburgim policor, gjë që ai pretendonte se ishte në kundërshtim me parimin e sigurisë ligjore dhe ishte në shkelje të Nenit 6 të Konventës.

Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 në lidhje me nenin 6 § 1** të Konventës, duke gjetur në veçanti që parashtruesit i ishte mohuar e drejta për ndihmë juridike në fazën e procedurës paraprake si rezultat i një kufizimi sistematik që vlente për të gjithë personat e akuzuar. Kjo nuk ishte në përputhje me kriteret e nenit 6 që e drejta për ndihmën e avokatit në fazat fillestare të marrjes në pyetje në polici mund t'i nënshtrohej kufizimeve vetëm nëse kishte arsye bindëse. Gjykata më tej vendosi se nuk kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 1** të Konventës në lidhje me mungesën e pretenduar të sigurisë juridike në lidhje me procedurat kushtetuese.

Ibrahim dhe të tierët k. Mbretërisë së Bashkuar

13 shtator 2016 (Dhoma e Madhe)

Më 21 korrik 2005 katër bomba u aktivizuan në sistemin e transportit në Londër, por nuk arritën të shpërthenin. Kryerësit u larguan nga vendi i ngjarjes dhe menjëherë filloi një hetim policor. Tre parashtruesit e parë u arrestuan nën dyshimin se kishin aktivizuar tri bomba. Parashtruesi i katërt fillimisht u intervistua si dëshmitar në lidhje me sulmet, por më pas u bë e qartë se ai kishte ndihmuar njërin nga bombarduesit pas sulmit të dështuar dhe ishte arrestuar edhe ai pasi kishte dhënë një deklaratë me shkrim. Të katër parashtruesit u dënuan më vonë për vepra penale. Rasti kishte të bënte me vonesën e përkohshme në sigurimin e qasjes në avokat, në lidhje me tre parashtruesit e parë, pas arrestimeve të tyre, dhe, në lidhje me parashtruesin e katërt, pasi policia kishte filluar të dyshonte për përfshirjen e tij në një vepër penale por para arrestimit të tij; dhe pranimin e deklaratave të tyre, të bëra në mungesë të avokatëve, në gjykimet pasuese .

Gjykata vendosi se nuk kishte pasur **shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)** (e drejta për gjykim të drejtë dhe e drejta për ndihmë juridike) të Konventës në lidhje me tre parashtruesit e parë dhe se kishte pasur **shkelje të atyre dispozitave** në lidhje me parashtruesin e katërt. Në lidhje me tre parashtruesit e parë, Gjykata ishte e bindur që, në kohën e marrjes në pyetje nga policia për herë të parë, kishte pasur nevojë urgjente për të shmangur pasoja tejet të rënda për jetën dhe integritetin fizik të publikut, përkatësisht sulme të tjera vetëvrasëse. Prandaj kishte pasur arsye bindëse për kufizimet e përkohshme të së drejtës së tyre për këshilla juridike. Gjykata po ashtu ishte e kënaqur që procedurat në tërësi në lidhje me secilin nga tre parashtruesit e parë kishin qenë të drejta. Pozicioni në lidhje me parashtruesin e katërt, i cili gjithashtu ankohej për vonesën e qasjes në avokat ishte i ndryshëm. Ai fillimisht ishte intervistuar si dëshmitar, dhe për këtë arsye nuk i ishte ofruar ndihmë juridike. Megjithatë, gjatë marrjes në pyetje u kuptua se ai kishte ndihmuar bombarduesin e katërt pas sulmit të dështuar. Në atë pikë, sipas kodit të praktikës në fuqi, ai duhej të ishte paralajmëruar dhe duhej t'i ofrohej këshilla juridike. Megjithatë, kjo nuk u bë. Pasi ai kishte dhënë një deklaratë me shkrim si dëshmitar, ai u arrestua, u akuzua, dhe më pas u dënua se kishte duke ndihmuar bombarduesin e katërt dhe nuk kishte informuar pas sulmeve. Në rastin e tij, Gjykata nuk ishte e bindur se kishte pasur arsye bindëse për kufizimin e mundësisë së tij për këshilla juridike dhe për dështimin për ta informuar atë për të drejtën e tij për t'u mbrojtur në heshtje. Ishte e rëndësishme që nuk kishte asnjë bazë në ligjin e brendshëm që policia të zgjidhte të mos e paralajmëronte atë në momentin kur kishte filluar të inkriminonte veten. Si pasojë ai ishte mashtruar në lidhje me të drejtat e tij procedurale. Më tej, vendimi i policisë nuk mund të rishikohej më vonë pasi nuk ishte regjistruar dhe nuk ishte dëgjuar asnjë provë për arsyet pas vendimit.

Pasi që nuk kishte ndonjë arsye bindëse, i binte Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të tregonte se procedurat ishin megjithatë të drejta. Sipas mendimit të Gjykatës, ata nuk ishin në gjendje ta bënin këtë dhe, në përputhje me rrethanat, nxori përfundimin se drejtësia e përgjithshme e gjykimit të parashtruesit të katërt ishte paragjykuar nga vendimi për të mos e paralajmëruar dhe për t'ia kufizuar mundësinë e qasjes në këshilla juridike.

Simeonovi k. Bullgarisë

12 maj 2017 (Dhoma e Madhe)

Parashtruesi, i cili aktualisht po vuan një dënim në një burg në Sofia, pretendonte në veçanti se nuk ishte ndihmuar nga një avokat gjatë ditëve të para të paraburgimit të tij. Dhoma e Madhe vendosi se nuk kishte pasur **shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)** (e drejta për gjykim të drejtë dhe e drejta për ndihmë juridike) të Konventës, duke gjetur se Qeveria Bullgare kishte paraqitur prova të rëndësishme dhe të mjaftueshme për të demonstruar se ata nuk kishin shkelur në mënyrë të pandreqshme drejtësinë e procedurave penale të marra si tërësi për shkak të mungesës të ndihmës juridike gjatë tre ditëve të para të ndalimit policor të parashtruesit. Në veçanti, Gjykata vuri në dukje se asnjë provë që do të mund të përdorej kundër parashtruesit nuk ishte marrë dhe futur në dosjen penale gjatë asaj periudhe dhe se parashtruesi, i ndihmuar nga një avokat i zgjedhur prej tij, kishte pranuar fajin vullnetarisht dy javë pasi ishte akuzuar, pasi ishte informuar për të drejtat e tij procedurale, përfshirë privilegjin kundër vetë-inkriminimit; që parashtruesi kishte marrë pjesë aktivisht në të gjitha fazat e procedimit penal; se dënimi i tij nuk ishte bazuar vetëm në pranimin e fajit, por edhe në një tërësi provash të qëndrueshme; që rasti ishte vlerësuar në tri nivele gjyqësore dhe se gjykatat vendore kishin dhënë arsye të duhura për vendimet e tyre si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik dhe kishin shqyrtuar si duhet çështjen e respektimit të të drejtave procedurale.

Beuze k. Belgjikës

9 nëntor 2018 (Dhoma e Madhe)

Parashtruesi, i dënuar me burgim të përjetshëm për vrasje me paramendim, ankohej se atij i ishte refuzuar qasja në avokat sa ishte në paraburgim policor, se nuk ishte informuar mjaftueshëm për të drejtën e tij për t'u mbrojtur në heshtje dhe për të mos inkriminuar veten dhe gjithashtu se ishte privuar nga ndihma juridike kur ishte marrë në pyetje, ose u ishte nënshtruar veprimeve të tjera hetimore gjatë hetimeve në procedurë paraprake.

Dhoma e Madhe vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)** (e drejta për gjykim të drejtë dhe e drejta për ndihmë juridike) të Konventës. Ajo gjeti në veçanti se procedurat penale, kur konsideroheshin si tërësi, nuk kishin korrigjuar defektet procedurale që ndodhin në fazën e procedurës paraprake. Kufizimet në të drejtën e qasjes në avokat kishin qenë veçanërisht të gjëra dhe në ato rrethana, pa qenë i informuar sa duhet për të drejtën e tij për t'u mbrojtur në heshtje, parashtruesi kishte dhënë deklaratat të hollësishme sa ishte në paraburgim policor. Deklaratat e tij më pas ishin përfshirë në prova para gjykatës penale, e cila kishte dështuar të bënte një ekzaminim të duhur se si ishin marrë ato ose të shqyrtonte ndikimin e mungesës së avokatit. Gjykata e Kasacionit ishte përqendruar në mungesën e ndihmës juridike në paraburgim policor por nuk kishte vlerësuar pasojat e mungesës së avokatit në të drejtat e mbrojtjes së parashtruesit gjatë intervistave të tij të mëvonshme në polici, ekzaminimeve nga gjyqtari hetues dhe akteve të tjera gjatë hetimit gjyqësor. Sipas këndvështrimit të Dhomës së Madhe, ndërthurja e këtyre faktorëve të ndryshëm i kishte bërë procedurat si tërësi të padrejta.

Doyle k. Irlandës

23 maj 2019

Ky rast kishte të bënte me ankesën e parashtruesit se e drejta e tij për qasje në avokat ishte kufizuar gjatë marrjes në pyetje për dyshimin e vrasjes. Ndonëse parashtruesi mund të këshillohej me avokatin e tij para intervistës së parë dhe më pas, praktika policore në atë kohë nënkuptonte që avokatët nuk ishin të lejuar të ishin të pranishëm gjatë marrjes në pyetje të policisë.

Gjykata vendosi se nuk kishte pasur **shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)** (e drejta për gjykim të drejtë dhe e drejta për ndihmë të përzgjedhur juridike) të Konventës.

Ajo vuri në dukje në veçanti se një kontroll shumë i rreptë duhej të zbatohet në rastet sikur ky, kur nuk kishte pasur arsye bindëse për të justifikuar kufizimin e të drejtës së parashtruesit për avokat. Megjithatë, pasi shqyrtoi procedurat në tërësi, Gjykata konstatoi se drejtësia e përgjithshme e gjykimit nuk ishte paragjykuar.

Olivieri k. Francës dhe Bloise k. Francës

11 korrik 2019¹

Të dy rastet kishin të bënin me periudhat e kaluara në paraburgim policor para reformës legjislative në prill 2011². Parashtruesit pretendonin se dënimet e tyre penale ishin bazuar në pranimet e fajit gjatë ndalimit në polici, gjatë së cilës kohë ata nuk ishin njoftuar për të drejtën e tyre për të heshtur dhe nuk kishin pasur ndihmën efektive të një avokati.

Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 1** (e drejta për gjykim të drejtë) **dhe 3 (c)** (e drejta për t'u ndihmuar nga një avokat) të Konventës në rastin e parë dhe **nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1 dhe 3 (c)** në rastin e dytë. Në rastin e parashtruesit të parë, dhe në lidhje me të drejtën e tij për të mos inkriminuar veten, Gjykata vuri në dukje veçanërisht ekzistencën e deklaratave dhe përgjigjeve dhënë hetuesve të cilat kishin prekur qartë pozicionin e tij në procedurë. Së pari, ai ishte marrë në pyetje nga policia për rreth dhjetë orë përderisa ishte në paraburgim policor kur edhe kishte pranuar përgjegjësinë. Së dyti, në arsyetimin e vendimeve të shtetit nuk kishte asgjë për të sugjeruar që elementë të tjerë mund të konsideroheshin si pjesë integrale dhe e rëndësishme e provave mbi të cilat ishte mbështetur dënimi i tij. Prandaj, Gjykata gjeti se procedurat penale, në tërësinë e tyre, nuk kishin korrigjuar defektet procedurale që kishin ndodhur në fazën e procedurës paraprake. Në rastin e parashtruesit të dytë, Gjykata vuri në dukje në veçanti se gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit kishin mbështetur vendimet e tyre në prova të tjera përveç deklaratave të dhëna në paraburgim policor, përkatësisht në provat e siguruara gjatë hetimeve, kur parashtruesi ishte ndihmuar nga një avokat, në seancat dëgjimore para gjykatës së shkallës së parë, në dëshmitë e sakta dhe të hollësishme të palëve të treta të lidhura drejtpërsëdrejti me aktivitetet e parashtruesit dhe në shqyrtimin e regjistrave të kontabilitetit dhe bankës. Gjykata gjeti se në atë rast procedurat penale, shikuar në tërësi, kishin korrigjuar defektet procedurale që ndodhën gjatë ndalimit në polici.

Rastet që kishin të bënin me të mitur

Salduz k. Turqisë

27 nëntor 2008 (Dhoma e Madhe)

I akuzuar e më pas i dënuar për pjesëmarrje në një demonstratë të paautorizuar në mbështetje të PKK-së (Partia Punëtore e Kurdistanit, një organizatë e paligjshme), parashtruesi, në mungesë të një avokati, bëri një deklaratë duke pranuar fajësinë sa ishte në mbajtje policore.

Gjykata konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me Nenin Neni 6 § 1** të Konventës. Ajo vuri në dukje në veçanti se një nga elementet specifike të rastit në fjalë ishte mosha e parashtruesit - që ishte i mitur në kohën e veprës. Duke pasur parasysh një varg të konsiderueshëm të materialeve relevante të ligjit ndërkombëtar në lidhje me ndihmën juridike për të miturit në paraburgim policor, gjykata theksoi rëndësinë thelbësore të sigurimit të qasjes në avokat kur personi në paraburgim është i mitur (shih paragrafin 60 të [aktgjykimit](#)).

Panovits k. Oipros

11 dhjetor 2008

Ky rast kishte të bënte veçanërisht me mosinformimin e parashtruesit, i cili ishte i mitur, për të drejtën e tij për t'u konsultuar me një avokat para marrjes në pyetje për herë të parë në polici.

1. Këto aktgjykime marrin formë të prerë në rrethanat e përcaktuara me Nenin 44 § 2 (aktgjykimet e formës së prerë) të [Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#).

2. Ligji në fuqi në kohën në fjalë nuk parashikonte që personat në paraburgim policor të njoftoheshin për të drejtën e tyre për të heshtur ose që të ndihmoheshin nga një avokat gjatë marrjes në pyetje.

Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)** të Konventës. Duke pasur parasysh rrethanat, dhe veçanërisht duke pasur parasysh moshën e parashtruesit dhe faktin që ai nuk ishte ndihmuar nga kujdestari i tij gjatë marrjes në pyetje, ajo zbuloi se mungesa e informacionit të mjaftueshëm mbi të drejtën e parashtruesit për t'u konsultuar me avokat para se të merrej në pyetje nga policia përbënte një shkelje të të drejtave të tij mbrojtëse.

Shih edhe: **Martin k. Estonisë**, aktgjykimi i 30 majit 2013.

Güvec k. Turaisë

20 janar 2009

Ky rast kishte të bënte veçanërisht me pamundësinë e një të pandehuri të mitur për të marrë pjesë në mënyrë efektive në gjykimin e tij penal dhe mungesën e përfaqësimit adekuat ligjor. Kur u mor në pyetje nga policia, dhe më pas nga prokurori dhe gjyqtari, parashtruesi nuk ishte i përfaqësuar nga një avokat. Gjatë rigjyimit, si parashtruesi ashtu edhe avokati i tij munguan në shumicën e seancave.

Gjykata konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (c)** të Konventës. Ajo konsideroi në veçanti që parashtruesi nuk kishte qenë në gjendje të merrte pjesë në mënyrë efektive në gjykim, duke qenë se ai nuk kishte marrë pjesë së paku në 14 nga 30 seancat dëgjimore si gjatë gjyimit fillestar ashtu edhe në rigjykim. Pasi shqyrtoi tërësinë e procedurave penale kundër parashtruesit dhe të metat e tyre, në veçanti mungesën e ndihmës juridike për pjesën më të madhe të procedurave, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të të drejtave të tij të mbrojtjes.

Soykan k. Turqisë

21 prill 2009

Në moshën 16 vjeçare, parashtruesi u arrestua dhe në fund u dënua me dy vjet e gjashtë muaj burgim për ndihmën e organizatës ilegale "Partia/Fronti Revolucionare e Çlirimit të Popullit" (Devrimci Halk Kurtuluş Cephesi Partisi - DHKP/C).

Ai ankohej në veçanti për shkeljet e të drejtave të tij mbrojtëse në procedurat penale kundër tij.

Gjykata konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 c në lidhje me Nenin Neni 6 § 1** të Konventës pasi që parashtruesi nuk kishte qasje në avokat gjatë mbajtjes në polici.

Adamkiewicz k. Polonisë

2 mars 2010

Në moshën 15 vjeçare, parashtruesi u akuzua për vrasjen e një djali 12-vjeçar. Ai ishte shpallur fajtor për akuzat kundër tij dhe u vendos në një institucion riedukimi për gjashtë vjet. Parashtruesi ankohej në veçanti për kufizimet e shqiptuara ndaj ushtrimit të të drejtave të tij mbrojtëse gjatë hetimit dhe faktin që deklaratat e bëra prej tij atëherë ishin pranuar në gjyq.

Gjykata konstatoi se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me nenin 6 § 1** të Konventës. Ajo vërejti në veçanti që parashtruesi nuk ishte informuar nga avokati për të drejtën e tij për të heshtur deri në gjashtë javë pasi kishte filluar procedura dhe ishte vendosur në një shtëpi për të mitur, pas disa përpjekjeve të pasuksesshme të avokatit të tij për ta takuar. Prandaj, autoritetet kishin marrë deklarinimin e tij që pranonte fajin para se ai të ishte informuar madje për atë të drejtë. Duke pasur parasysh moshën e tij, nuk mund të pohohej se parashtruesi dinte për të drejtën e tij për të kërkuar përfaqësim ligjor dhe për pasojat e dështimit të tij për ta bërë këtë, ndërsa ishte thelbësore për të, i izoluar në një shtëpi për të mitur, siç kishte qenë gjatë periudhës vendimtare të hetimeve, që të ketë qasje të plotë në avokat që nga fillimi i procedurës.

Dushka k. Ukrainës

3 shkurt 2011

Ky rast kishte të bënte me ndalimin dhe marrjen në pyetje të paligjshme pa avokat të një 17-vjeçari. Parashtruesi pretendonte se ai ishte torturuar në paraburgim policor në mënyrë që ta pranonte fajin për një grabitje.

Gjykata konstatoi se një praktikë e tillë, veçanërisht duke pasur parasysh moshën e ndjeshme të parashtruesit, e cilësuar si trajtim çnjerëzor dhe degradues, përbënte **shkelje të nenit 3** (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës. Në veçanti fakti që pranimi i veprës ishte bërë në një mjedis që nuk kishte garanci të tilla procedurale si prania e një avokati, dhe më pas tërheqja e deklaratës, tregonin se mund të mos ishte dhënë lirshëm.

Blokin k. Ruisë

23 mars 2016 (Dhoma e Madhe)

Ky rast kishte të bënte me ndalimin për 30 ditë të një djali 12-vjeçar të shqetësuar mendërisht në një qendër të përkohshme për të mitur. Parashtruesi pohonte veçanërisht se procedurat kundër tij kishin qenë të padrejta sepse ai dyshohet se ishte marrë në pyetje nga policia në mungesë të kujdestarit të tij, avokatit ose një mësuesi.

Dhoma e Madhe vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3** të Konventës. Ajo u pajtua me vendimin e Dhomës në këtë rast që procedurat në lidhje me vendosjen e djalit në qendrën e ndalimit të përkohshëm do të konsideroheshin procedim penal për qëllimet e nenit 6, megjithëse ato nuk ishin klasifikuar si kriminale sipas ligjit rus. Në veçanti, gjykatat vendore i ishin referuar faktit se djali kishte kryer një veprim delikuent si arsyeja kryesore për vendosjen e tij në qendrën e paraburgimit. Të drejtat e tij mbrojtëse ishin shkelur sepse ai ishte marrë në pyetje nga policia pa ndihmë juridike dhe deklaratat e dy dëshmitarëve të cilët ai nuk ishte në gjendje t'i kundërshtonte kishin shërbyer si bazë për vendosjen e tij në paraburgim të përkohshëm.

Heqja dorë në mënyrë vullnetare nga e drejta për ndihmë të avokatit

Zaichenko k. Ruisë

18 shkurt 2010

I dënuar për vjedhje të naftës nga kompania për të cilën ai punonte si shofer dhe i dënuar me burgim me kusht, parashtruesi ankohej se dënimi i tij ishte bazuar në pranimet që ai kishte bërë në polici para gjyqit në mungesë të një avokati.

Gjykata konstatoi se nuk kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me Nenin Neni 6 § 1** të Konventës. Ndonëse parashtruesi nuk kishte qenë i lirë të largohej kur u ndalua më 21 shkurt, rrethanat e rastit nuk zbuluan asnjë kufizim të konsiderueshëm të lirisë së tij të veprimit që do të ishte i mjaftueshëm për të aktivizuar kërkesën për ndihmë juridike në atë fazë. Roli i policisë kishte qenë të hartonte një procesverbal të inspektimit të makinës dhe të dëgjonte shpjegimet e parashtruesit për origjinën e bidonëve.

Ai informacion i ishte kaluar një hetuesi i cili kishte përpiluar një raport mbi bazën e të cilit eprori i tij kishte vendosur të hapte një rast penal kundër parashtruesit. Në atë fazë (2 mars 2001) parashtruesi informuar për të drejtën e tij për ndihmë juridike, por vullnetarisht dhe pa kurrfarë dyshimi pranoi të nënshkruante aktin e akuzës dhe hoqi dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike, duke treguar që do të mbrohej vetë në gjyq.

Yoldas k. Turqisë

23 shkurt 2010

I mbajtur në paraburgim policor me akuzat e anëtarësimit në një organizatë të paligjshme, parashtruesi u dënua në fund të gjyqit të tij me burgim të përjetshëm. Ai ankohej në veçanti për faktin se nuk ishte ndihmuar nga një avokat sa ishte në paraburgim policor.

Gjykata vendosi se nuk kishte pasur **shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)** të Konventës. Duke theksuar në veçanti se ndonëse kishte të drejtë të ndihmohej nga një avokat gjatë ndalimit në polici dhe se atij ia kishin kujtuar atë të drejtë, parashtruesi kishte refuzuar ndihmën, gjykata gjeti se asgjë në procedurë nuk jepte arsye për të dyshuar se heqja dorë nga e drejta për t'u ndihmuar nga një avokat sa ishte në paraburgim policor nuk kishte qenë me vullnet të lirë dhe e qartë.

Akdağ k. Turqisë

17 shtator 2019³

Parashtruesja pretendonte se kishte pranuar se ishte anëtare e një organizate të paligjshme pasi ishte kërcënuar dhe keqtrajtuar nga policia, pa qasje në avokat në paraburgim policor.

Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)** të Konventës. Ndonëse e kishte hedhur poshtë si të papranueshme ankesën e parashtrueses se dënimi i saj ishte bazuar në deklaratat e dhëna në polici nën presion, për shkak të mungesës së provave të keqtrajtimit, gjykata gjeti se qeveria turke nuk kishte arritur të tregonte se si një shenjë "X" e shtypur pranë "nuk është kërkuar avokat" në formularin e deklaratës së saj tregonte se ajo vërtet kishte hequr dorë nga e drejta e saj për avokat gjatë mbajtjes. Në fakt, sapo kishte siguruar qasje në një avokat kah fundi i mbajtjes, ajo kishte tërhequr deklaratat e saj. As Gjykata nuk ishte e kënaqur me përgjigjen e gjykatave kombëtare ndaj ankesës së parashtrueses. Ato nuk kishin shqyrtuar as vlefshmërinë e heqjes dorë e as deklaratat që ajo kishte dhënë në polici në mungesë të një avokati. Mungesa e tillë e shqyrtimit nuk ishte korrigjuar nga ndonjë mbrojtje tjetër procedurale, andaj drejtësia e përgjithshme e procedurave kundër saj ishte paragjykuar.

Mungesa e një përkthyesi gjatë marrjes në pyetje në polici

Baytar k. Turqisë

14 tetor 2014

Ky rast kishte të bënte me marrjen në pyetje në paraburgim të policisë, pa ndihmën e një përkthyesi, të një personi që nuk e zotëronte mjaftueshëm gjuhën kombëtare.

Gjykata gjeti se kishte pasur **shkelje të Nenit 6 § 3 (e)** (e drejta për ndihmën e një përkthyesi) **në lidhje me Nenin 6 § 1** të Konventës. Ajo gjeti në veçanti se, pa mundësinë që asaj t'i përktheheshin pyetjet që ajo të kishte një ide sa më të saktë të veprave të pretenduara, parashtruesja nuk ishte në gjendje t'i kuptonte plotësisht pasojat e heqjes dorë nga e drejta për t'u mbrojtur në heshtje dhe nga e drejta për ndihmë juridike.

Humbja e statusit të "viktimës" në rast të shpalljes i pafajshëm

Bouglame k. Belgjikës

2 mars 2010 (vendim mbi pranueshmërinë)

Ky rast kishte të bënte me mohimin e ndihmës juridike parashtruesit sa ishte në paraburgim policor për akuzat në lidhje me trafikimin ndërkombëtar të drogës. Ai më pas u lirua nga akuzat nga gjykata e shkallës së parë, gjykimi i së cilës u konfirmua në apel.

Gjykata e shpalli kërkesën si **të papranueshme** (qartazi të pabazuar). Duke qenë i pafajshëm, parashtruesi nuk mund të pretendonte më të ishte "viktimë" e shkeljes së nenit 6 të Konventës.

3. Ky aktgjykim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara me Nenin 44 § 2 të [Konventës](#).

Ligjshmëria e paraburgimit në mungesë të ndihmës së avokatit

Simons k. Belgjikës

28 gusht 2012 (vendim mbi pranueshmërinë)

Ky rast kishte të bënte me një paraburgim që pretendohet të ishte i paligjshëm për shkak të mungesës së përfaqësimit ligjor gjatë ndalimit të policisë dhe marrjes në pyetje nga gjyqtari hetues. Duke u mbështetur në nenet 5 § 1 (e drejta për liri dhe siguri), 6 § 1 (e drejta për gjykim të drejtë) dhe 6 § 3 (c) (e drejta për t'u ndihmuar nga një avokat) të Konventës, parashtruesja ankohej se për shkak se ligji belg ishte joadekuat, ajo nuk ishte ndihmuar nga një avokat gjatë mbajtjes në polici ose në intervistën e saj nga policia, ose ekzaminimi i saj i parë nga gjykatësi hetues dhe nuk ishte njoftuar për të drejtën e saj për t'u mbrojtur në heshtje.

Meqenëse rasti ishte ende i hapur në gjykatat vendore, Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte e parakohshme nga pikëpamja e **nenit 6** (e drejta për gjykim të drejtë) të Konventës dhe, në përputhje me nenin 35 (kriteret e pranueshmërisë) të Konventës, ajo **refuzoi** këtë pjesë të kërkesës.

Sipas **nenit 5** (e drejta për liri dhe siguri) të Konventës, Gjykata duhej të konstatonte nëse ekzistonte ndonjë "parim i përgjithshëm" i nënkuptuar në Konventë, sipas të cilit të gjithë personat e privuar nga liria duhej të kishin mundësinë të ndihmoheshin nga një avokat nga fillimi i ndalimit të tyre. Gjykata vuri në dukje se, sipas praktikës së saj gjyqësore, personat e akuzuar kishin të drejtë të ndihmoheshin nga një avokat që nga fillimi i kohës së tyre në mbajtje policore ose paraburgim dhe kur merren në pyetje nga policia ose gjykatësi hetues. Ndonëse disa kufizime të kësaj të drejte mund të justifikohen në kushte të caktuara, fakti i pamundësisë për të siguruar ndihmën e një avokati në rrethana të tilla për shkak të një rregulli të ligjit të brendshëm ishte i papajtueshëm me të drejtën për gjykim të drejtë. Megjithatë, ky ishte një parim i mishëruar në të drejtën për gjykim të drejtë, i cili bazohej posaçërisht në Nenin 6 § 3 të Konventës në lidhje me të drejtën e çdo të akuzuari për t'u ndihmuar nga një avokat i zgjedhur prej tij ose të saj. Nuk ishte "parim i përgjithshëm" i nënkuptuar në Konventë, parimet e tilla janë nga natyra mbizotëruese. Prandaj, edhe pse pamundësia në ligj për personat e akuzuar në paraburgim për t'u ndihmuar nga një avokat që nga fillimi i ndalimit të tyre kishte ndikim në drejtësinë e procedurës penale, kjo nuk nënkuptonte që ndalimi në fjalë përbënte shkelje të **Nenit 5 § 1** (e drejta për liri dhe siguri) të Konventës. Kërkesa e parashtruesit ishte qartazi e pabazuar nga pikëpamja e asaj dispozite, dhe Gjykata e deklaroi atë **të papranueshme**.

Kontakti i medias:

Tel.: +33 (0)3 90 21 42 08